

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së, vajza e Jakup Krasniqit: Padrejtësia është e madhe, por e vërteta mbetet
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392070.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 13:05:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	16 shtator 2026, 13:02:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 16 shtator 2026, 13:01:00 UTC → 16 shtator 2026, 13:03:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t'ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5c36b820f6a73e391b2a5f30676aec72f538064c82b811b6253e0f0aee98789c
TEKSTI	93264be884454f8eabef7757046396fd883af79d943bbaee46b8c9ed95e93cf8
PAMJA	3bda8fa1d7acaf7f5e4660b9f3cb09698c216efce8bb4987c47902849ee0a2c8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	66df12baffbabccb5c4601f6add3d7e223cb54b3ed9f8d274f73d8f1ae1b05ee
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9235283646fceb4f2e036f737b53ac1b0d6441cb2e31166fde86e3118480b863
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/66df12baffbabccb5c4601f6add3d7e223cb54b3ed9f8d274f73d8f1ae1b05ee>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së, vajza e Jakup Krasniqit: Padrejtësia është e madhe, por e vërteta mbetet

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 16.09.2026, 15:02



Share



Share



Vendimi i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë për ish-drejtesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka shkaktuar reagime të forta, ndërsa familjarët e të dënuarve kanë shprehur zhgënjimin e tyre pas shpalljes së aktgjykimit.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, janë dënuar me nga 25 vjet burgim. Kadri Veseli është dënuar me 18 vjet, ndërsa Rexhep Selimi me 13 vjet burgim.

Pas vendimit, ka reaguar edhe Gresa Krasniqi, vajza e Jakup Krasniqit. Përmes një postimi në Facebook, ajo ka shprehur dhimbjen dhe zhgënjimin e saj, duke theksuar se besimi në pafajësinë e babait të saj dhe të bashkëakuzuarve nuk është lëkundur.

"Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, sot, në qytetin e drejtësisë, ndodhi padrejtësia më e madhe e këtij shekulli", ka shkruar ajo.

Krasniqi e ka cilësuar vendimin si një padrejtësi të rëndë dhe ka pretenduar se procesi dhe aktgjykimi janë të motivuara politikisht. Sipas saj, vendimi dëmton edhe figurën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe mënyrën se si ajo përfaqësohet në historinë e Kosovës.

Në reagimin e saj, ajo është ndalur edhe te periudha e luftës në Kosovë, duke argumentuar se katër të dënuarit morën armët për të mbrojtur familjet dhe popullsinë nga dhuna dhe dëbimet.

"UÇK-ja luftoi kundër kasapit të Ballkanit, kundër një prej ushtrive më të përgjakshme të rajonit, kundër një makinerie ushtarake që kreu gjenocid në Kosovë. E megjithatë, sot u dënuan çlirimtarët", ka deklaruar ajo.


Krasniqi ka ngritur gjithashtu një krahasim me figura politike serbe, duke përmendur rastin e ish-zëdhënësit të UÇK-së dhe duke pretenduar se homologu i tij i atëhershëm, Ivica Daçiç, vijon të jetë i lirë në Beograd. Sipas saj, ky është një tjetër element që ngre pikëpyetje mbi mënyrën se si është zhvilluar procesi.

Pavarësisht vendimit, vajza e Jakup Krasniqit ka thënë se familja nuk do të heqë dorë nga bindjet e saj.

"Unë jetoj dhe do të vdes me bindjen time të plotë në pafajësinë dhe çiltërsinë e babait tim, Hashimit, Kadriut dhe Rexhës", ka shkruar ajo.

Në përfundim të reagimit, Gresa Krasniqi ka përcjellë mesazhin se, pavarësisht dhimbjes dhe zhgënjimit të shkaktuar nga aktgjykimi, qëndrimi i saj ndaj babait dhe bashkëakuzuarve mbetet i pandryshuar.

"Krenaria mbetet. E vërteta mbetet. Ne do ta vazhdojmë luftën për liri dhe drejtësi", ka përfunduar ajo.



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

[Puno me ne!](#)

[Marketing](#)

[Politika e privatësisë](#)

[Rreth Nesh](#)

[Kushtet e përdorimit](#)

[Kontakt](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.